

**Akt-Themelimi****i shoqërise tregtare****“SORS Consulting” SH.P.K.**

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarin dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe të ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Q.K.R”, të ndryshuar, me vullnetin e tyre të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, ne ortakët:

**Boris Antonio Pedretti-Berudi** - me nr. [REDACTED] në Locarno, më datë 12.06.1969, banues në via In Campagn, 22/b, 6528 Camorino (Zvicër)

**Anxhela Kurti**, - me nr. karte identiteti/Person [REDACTED] lindur në Elbasan, më datë 24.07.1995, banues në Elbasan,

sot më datë 10/10/2022 krijojmë shoqërine tregtare me përgjegjësi të kufizuar “SORS Consulting” SH.P.K., funksionimi i së cilës do të nënshtrohet këtij Akti Themelimi, Statutit të miratuar dhe legjislacionit shqiptar në fuqi,

me akt themelimi si vijon :

## Emërtimi

## Neni 1

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur “SORS Consulting sh.p.k.”.

Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të këtë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

## Selia e Shoqërise

## Neni 2

Selia e shoqërise tregtare “SORS Consulting” shpk ndodhet në adresën: **ELBASAN. Njesia administrative SHUSHICE, Fshati HAJDARAN, Rruga Theodor Haxhifilipi nr. ap 23 Zona Kadastrale 1919 Nr. Pasurie 25/72/2 + 1-24..**

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë.

## Objekti i Veprimtarise


## Neni 3

Shoqëria zhvillon aktivitetin tregtar të mëposhtëm:

*Pedretti-Berudi Boris Antonio*

1

*Anxhela Kurti*



Të menaxhojë platforma shitjesh me përfaqësim në terren të markave të ndryshme, të promovojë produkte sipas kontratave të lidhura me klientë të ndryshëm, brenda apo jashtë vendit.

Të ushtrojë aktivitet konsulence, përfaqësimi tregtar, marketingu, këshillim ligjor për kompani, aktivitet agjencie apo komisioneri, etj.

Të ofrojë shërbime të trajnimit profesional në fusha të ndryshme që kanë lidhje me objektin e shoqërisë.

Çdo lloj veprimi tregtar, industrial e financiar, mobiluar e jo mobiluar , duke përfshirë ndertimin shitjen dhe menaxhimin e ndërtesave që kanë të bëjnë me qëllimin e shoqërisë. Ndërmjetësim në shitje-blerje pasurish të paluajtshme Shitje të produkteve dhe shërbimeve on-line, kurse formimi teknik informatike, shoqëria mund të zhvillojë të gjitha veprimtaritë industriale, tregtare , financiare mobiliare dhe imobiliare që kanë lidhje me objektin e shoqërisë dhe që janë të nevojshme për arritjen e qëllimit të objektit të shoqërisë. Shërbim mirëmbajtje serveri, rrjeti kompjuterike dhe programe, Mirëmbajtje server dhe hardëare. Mirëmbajtje e rrjetit të informacionit, Prodhim fletëpalosje, postera, fletë informuese. Organizim dhe zhvillim i një fushatë publicitare.

#### Kohëzgjatja e Shoqërisë

##### Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat. Ajo mund shpërbehet në cdo kohë dhe për çfardo lloj shkak.

#### Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

##### Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë private "SORS Consulting" sh.p.k do të jetë 100.000 leke. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është:

1. Ortaku themelues z. . Boris Antonio Pedretti-Berudi: zotërues i \_\_\_1\_\_\_kuote me vlerë 80.000 lekë që përben 80 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues znj. Anxhela Kurti: zotërues i \_\_\_1\_\_\_kuote me vlerë 20.000 lekë që përben 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi fillestar i ortakëve është në para.


#### Drejtimi i Shoqërisë

##### Neni 6

*Pedretti-Berudi Boris Antonio,*

2

*Anxhela Kurti*



Organet drejtuese të shoqërisë janë :

1.Asambleja e ortakëve

2.Administrimi

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, i cili është dhe përfaqësuesi ligjor i saj .

Administratori është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj, me përjashtim të kompetencave të cilat i ka asambleja e ortakëve, sipas përcaktimeve në statut.

Administrator i parë i shoqërisë, me një afat 5-vjeçar nga data e regjistrimit në QKB, është znj. **Anxhela Kurti**.

Ortakët, në momentin e firmosjes të këtij akti themelimi, deklarojnë se i njohin detyrimet ligjore të përcaktuara në Ligjin 9901 datë 14.04.2008, të ndryshuar, dhe në veçanti përcaktimet e neneve 13, 17 dhe 206 e vijues të këtij Ligji.

Me këtë akt themelimi ngarkohet administratori të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar, në organet tatimore dhe të kryejë veprimet e nevojshme në bankat e nivelit të dytë.

#### Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve.

#### Neni 8

Asambleja e ortakëve ka të drejtë të emerojë dhe administratorë të tjerë. Ka të drejtë të caktojë financiere, likuidator për problemet e shoqërisë.

#### Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqipëtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

#### Neni 10

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.


#### Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi dhe vecanërisht të Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi rregullohen në Statut dhe në legjislacionin shqiptar.

Anxhela Kurti



Tedelt: Besnik Bani Anxhela Kurti




Neni 12

Akti i themelimit u përpilua në dy gjuhë, që kanë vlerë të njejtë për interpretimin, në shqip dhe në italisht. Secila nga ato është në 4 kopje: dy kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe dy kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë .

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga të dy ortakët themelues.

  
Boris Antonio Pedretti-Berudi  


ORTAKËT THEMELUES

  
Anxhela Kurti  
